

KARLO KOLODI  
**AVENTURAT E PINOKUT**

---

BOTIMET TOENA





KARLO KOLODI

# AVENTURAT E PINOKUT

*Përktheu nga origjinali Zija VUKAJ*

*Ilustruar nga Xheneta KADILLARI*

BOTIMET TOENA

Tiranë

Autori: Carlo Collodi

Titulli në origjinal: Le avventure di Pinocchio (la storia di un buratino)

Botuar për herë të parë në italisht, në 1883.

Botuese: Irena Toçi

Redaktor letrar: Eris Rusi

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Ilustrimet *dhe* kopertina: Xheneta Kadillari

Përkujdesja grafike: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928817952

© i përkthimit BOTIMET TOENA

© i ilustrimeve BOTIMET TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha", nr. 71

Tiranë 1023.

K. Postare 1420.

Tel.: ++ 355 4 22 40 116

Email: [botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[toena.porosionline@gmail.com](mailto:toena.porosionline@gmail.com)

<https://toena.al>

“Druri nga është prerë Pinoku, është njerëzimi, është ai që ngrihet në këmbë dhe hyn në jetë si njeriu që ndërmerr rishtarinë e tij; kukull: por krejt shpirtëror.”

–Benedeto KROÇE



## PINOKU

*një përrallë e mistershme*

**J**deja më e bukur mes shumë të bukurave, që pleksen në aventurat e Pinokut del në rreshtat e parë të librit. Brenda copës së thjeshtë të drurit për zjarr, të ndodhur s’dihet se si në dyqanin e mjeshtër Qershisë, rri fshehur “një zëth i hollë, i hollë”, që ankohet nga dhimbja apo qesh nga gudulisja. Nga del ai zë i mbyllur në dru? Kush është ai xhind, ai *shkurtabiq*, ai “elf” i parespektueshëm e i pavlerësuar, që endet prapa kuintave të botës? S’dimë të përgjigjemi. Vetëm një gjë është e qartë. Pinoku jeton, ka një psikologji dhe një formë të skalitur përsosmërisht, akoma para se Xhepetoja të fillonte ta gdhendte e t’i gjente një emër. Pa vënë kurrë këmbë mbi tokë, zotëron një përvojë shumë të sigurt për jetën tonë: di çfarë është puna dhe jeta endacake, fëmijëria e pleqëria, çfarë joshjesh prekin zemrën e një njeriu, si duhet gatuar një vezë e si duhet qeruar një dardhë. Kështu asnjë lexues nuk çuditet nëse të gjithë personazhet - kukullat e Zjarrngrënësit,

Bulkthi-urtak, zogu që sapo del nga veza, maçoku e dhelpra - e njohin pa e takuar kurrë më parë: sikur një bashkëpunim i fshehtë apo informacione të cilave nuk ua dimë burimin, i shtyjnë drejt qendrës së librit të tyre.

Ndonjë orë pas shfaqjes në dyqanin e mjeshtër Qershisë, Pinoku pëson mishërimin e parë. “Zëthi i hollë, i hollë”, herë përqeshës herë i përvajshëm, ka një fytyrë, një hundë, një trup një veshje prej letre me lule dhe zë vend në galerinë universale të kukullave. Deri në fund të librit do të vazhdojë ta mbajë larg nesh një ndryshim i pakapërcyeshëm. Ndërsa ne i njohim në shpirt reagimet e fundit që na ndodhin në trup, bëhemi melankolikë për shkak të një ftohjeje ose të gëzuar nëse murlani pastron befaz retë nga qielli, Pinoku ka një trup që nuk i përket. Këmbët marrin zjarr dhe shkumbohen pa vuajtur ai; dhe thikat e gjata e të mprehta të vrasësve copëtohen pas shpinës së tij të fortë, të fortë si mendja e tij shpotitëse. Por, pikërisht se nuk i përket, trupi i Pinokut nuk e njeh përtesën e materies dhe u lëshon të gjithëve dëshirat e fantazisë fëminore. Ndoshta nuk e kuptojmë kurrë kaq qartë Pinokun, si në rastet kur përshkon fushat e Toskanës e të Përrallës, duke kërcyer “rripa shumë të lartë, gjerdhe shkurresh e hendeqe plot me ujë me shpejtësinë e një langoi apo të një lepuri të ndjekur nga gjahtarët; ose kur noton në det, bën kërcime e laradashë me zhdërvjelltësinë e një “delfini në qejf”.



Çfarë mund të bëjë një kukull e ardhur në botën e njerëzve? Mund të përshkojë dy rrugë: të kërkojë të na ngjajë; ose t'u rezistojë ligjeve të ekzistencës sonë, duke u kundërvënë lehtësinë, shpejtësinë dhe hirin e automatizmave të vet, që - siç thoshte Kleist - riprodhojnë diçka nga hiri i Zotit. Nuk dua ta bëj Kolodin një shkrimtar romantik. Por të paktën një herë në jetën e vet, do t'i kenë ardhur në mendje ide të ngjashme me ato të Kleist e të Hofman. Në atë kryevepër të çuditshme “Pinoku” që është “Majmuni me ngjyrë të kuqe”, protagonistin i vogël reziston të ulërijë e të qajë ndaj atij që (pikërisht Zana me flokë të kaltër) do ta shndërrojë në një “përbindësh të frikshëm”: një qenie njerëzore.

Pinoku zgjedh rrugën e parë. Edhe pse është kukull kokë e këmbë, nuk bën asnjë përpjekje për të mbrojtur natyrën e vet: kërcimet, laradashët, vrapimet marramendëse, lojërat e papërgjegjshme për të brofur si peshk. Tek ai, kaq i fortë e tallës, ekziston një prirje njëlloj e fortë që e shtyn të ndryshojë e të bëhet një qen i shkëlqyer roje, një shkollar i përsosur, një gomar i pakrahasueshëm dhe në fund një “fëmijë i mirë”. Kështu ai pranon të rritet, të bindet, të shkojë në shkollë; dhe detyron fantazinë e tij të shfrenuar - një fantazi romancieri a mitomani më shumë se e një fëmije - në kufijtë tepër të ngushtë të realitetit. Duket se

nuk e prek asnjë keqardhje për botën e tij të zërave e të shpirtrave, të drurit e të kuintave teatrale. Një dëshirë thuajse e dëshpëruar afektive e shtyn “si gjithë fëmijët e tjerë”, drejt një babai e një nëne. Pak gjëra më duken më mallëngjyese se sa përpjekja e tij e pafajshme për të ndërtuar me imagjinatë një të kaluar të gjatë, bashkë me Xhepeton, ndërsa ka jetuar me të pak orë; dhe në shikimet e dashura, puthjet e zjarrta që i hedh “thuajse jashtë vetes”, zanës me flokë të kaltër.

Në fillim të kapitullit të shtatëmbëdhjetë, “Aventurat e Pinokut” ndryshojnë ton. Ai realitet i kufizuar, ajo Toskanë bujqësore e pastër dhe e varfër, e mbushur me pleq tekanjozë, me mejhanexhinj të paskrupull, me karabinierë e bataçqinj shtinjakë e mizorë, befas vizitohet nga një vegim. Ja tek del nga pemët e errëta të një pylli Zana e përrallave të vjetra: e pavdekshmja Zonja e Kafshëve, Mbretëresha e Metamorfozave, Endësja e matur dhe e përpiktë e fateve. Siç është e natyrshme, Zana mbulohet pas dukjes më të thjeshtë, mes karameleve lulëlake dhe sheqerkave e pijeve të ëmbla; dhe i shfaqet Pinokut në formën e motrës, nënës, edukatores, aq e dashur për traditën romantike. Asnjë gjurmë tërheqjeje erotike nuk jep as nga larg figura e saj, që është e lidhur me ndonjë marrëdhënie të errët me mbretërinë e zbehtë të vdekjes, si shumë heroina të Dikensit, që i ngjajnë thellësisht. Tashmë libri e ka

gjetur kulmin e vet. S'ka rëndësi se në të gjithë rrëfimin Zoti nuk përmendet asnjëherë dhe nuk ka asnjë gjurmë figure atërore. Figura e buzëqeshur mëmësore zë pa konkurrentë horizontin që i mbivendoset kthesës së ngjarjeve tokësore.

Sapo shfaqet në skenë, Zana me flokë të kaltër e mbisundon tregimin: end, tjerr, përgatit fate, planifikon aventura; dhe ndërkaq fshihet, shndërrohet e trajtësohet, herë e bardhë si një imazh dylli, herë Vogelushja e bukur me flokë të kaltër, herë si banore që punon në ishullin e Bletëve, herë zonjë me medaljon, herë kec i kaltër, herë e sëmurë në fund të një shtrati spitali. Kështu edhe Pinoku, i ardhur nën shenjën e Mbretëreshës së Metamorfozave, duhet të shndërrohet. Aventurat e tij, që deri tani kishin qenë rastësore dhe rravguese si në një roman pikaresk, fillojnë të përvijojnë linjën e një nisme.

Etapat e kësaj nisme janë të njohura. Si në shumë tregime simbolike, një çast para gjysmës së fundit, mëkati më i rëndë i ekzistencës së tij ndërpret ngjitjen e ngadaltë të Pinokut. Në natën e errët e tinëzare që po mbështjell tokën, ai dëgjon fjalët tunduese të Filitit, shkon me të në vendin e lodrave dhe bëhet gomar, duke zbritur kështu nën natyrën e tij prej kukulle, meqë gomarët, të vetmit mes të gjithë personazheve njerëzorë e shtazorë të librit, flasin në “dialekt”. Pastaj

shitet për njëzet para, hidhet në det e mbytet. Në këtë moment, linja e fatit të tij përmbysset sërish. I hedhur pa mëshirë në humnerën e vdekjes, i flakur si një gur në detin e jetës, Pinoku ngrihet sërish drejt dritës. Ai nuk ka asnjë meritë për shpëtimin e vet: çlirohet për “hir” nga Zana, Zonja e Kafshëve, që çon një tufë peshqish për të përparë trupin e tij prej gomari.

I çliruar nga veshjet e huaja, Pinoku rilind kukull; dhe përpëlitjet gazmore të ngjalës, laradashët e gëzueshëm të delfinit, kërcimet e lumtura që bën mbi sipërfaqen e detit, janë himni i gazmendit i atij që më në fund ka rigjetur formën e vet. Por ky gëzim nuk vazhdon gjatë. Për t’u “shndërruar” plotësisht, Pinoku duhet të heqë dorë nga vetvetja. Gjithçka ndodh një natë tjetër, ndriçuar nga shkëlqimi i yjeve e i hënës së plotë. Pinoku merr babanë për dore, ngjit grykën e Peshkaqenit, noton me Xhepeton mbi supe dhe mbërrin tokën e sigurt. Kujdeset me dashuri për babanë e sëmurë, bën shporta dhe karroca dore, rrotullon rrethin me kova në vend të gomarit, mëson të lexojë e të shkruajë dhe kursen si një fshatar toskan. Kush do të njihte më në këtë djalë të fortë e punëtor, krijesën prej druri të lindur në një natë të largët dimri? Tashmë Pinoku është babai dhe zotëria i vetvetes: babai i babait të vet; një Robinson i qytetëruar, që jeton në barakën e tij ishull, duke pranuar të gjithë ligjet shoqërore dhe përpigjet të ndryshojë karakterin e vet siç punon një artizan hekurin e drurin.

Kështu, i shpërblyer për “merita” që tani i zotëron vërtet, Pinoku bëhet më në fund një “djalë për së mbari”, me një veshje të re dhe një palë çizme lëkure që e kthejnë në një pikturë të vërtetë. Ky përfundim nuk ka kënaqur kurrë askënd, përveç fëmijëve, që e gjykojnë gjënë më të mrekullueshme të librit. Nuk dua ta mbroj tepër. Dua të rikujtoj vetëm se, në çfarëdo historie ceremoniale fillese, shndërrimi i fundit mund të përmendet vetëm me alegori dhe imazhe pa ngjyrë. Shumë fillesa janë, së bashku, një ngjitje e një rënie, sepse diçka e bukur, e çmuar, e rrallë duhet braktisur rrugës: çiltërsia e fëmijërisë, paqartësia e dashur e adoleshencës, cektësia e kukullës.

Ndërsa mua më pëlqen të kujtoj një fakt të harruar, më duket, nga çdo lexues. Kur Pinoku bëhet fëmijë, më përvëluesja e dëshirave të tij nuk realizohet. Ai mbetet jetim. Një shkrimtar tjetër, më i dobët e sentimental se Kolodi, do ta shndërronte Zanën me flokë të kaltër në nënën e tij tokësore. Por Zana nuk zbret pranë tij, nuk bëhet nëna e ëndërruar dhe e shpresuar, nëna që vë dorën mbi ballë e pagjumë, që kujdeset, udhëheq e ndëshkon. Zana i shfaqet herën e fundit, në ëndërr; e pastaj largohet përgjithmonë. Asgjë më e jashtëzakonshme se kjo zhdukje përfundimtare që asnjë fjalë nuk e qan apo e kujton.

Nuk e di nëse ky libër që sapo e përfundova së treguari i ngjan “Aventurave të Pinokut” që njohin të gjithë.

Ndokush mund të më akuzojë se e kam shndërruar në një lloj “Flauti magjik” ose në një përrallë romantike si “Zana e thërrimeve” të Charl Nodier. Natyrisht mjedisi ku jetonte Kolodi nuk mund të ishte më larg se Vjena e ndriçuar prej Moxartit; apo se bibliotekat e vërteta dhe imagjinare të Parisit, ku banonte, flinte dhe ëndërronte Nodier. Ky njeri i zakonshëm, i thjeshtë dhe i heshtur me mungesa respekti të padëmshme studentore, i përndjekur nga frika e hajdutëve, i dashuruar me cigaret toskane, me nënën e me kuzhinën e mirë: ky plak, beqar i pastër, me vetulla të dendura, fytyrë të plotë ngjyrë mavi dhe një “mjekër të madhe husari apo qeni mjekrosh”, që ecte me qëndrim të rreptë, i ngrefosur e pak kapadai si ushtari me leje, mund të jetonte vetëm, si një bar që ka përqafuar me ngulm plasat e trotuareve, në Firencen e gjysmës së dytë të shek. XIX. Asnjë libër nuk është më toskan se i tiji. Njohja e hidhur, e egër e pa dritën e realitetit: zvogëlimi i çdo fantazie, i çdo ëndrre, i çdo përralle, e çdo dëshire fëminore, e çdo përbindëshi legjendar brenda kufijve më familjarë (vetëm Kolodi mund të hynte në barkun e një balene për të gjetur aty aromat e një gjellëtoreje fiorentine): gjeometria e përkryer e ndërtimit, e rrëfimit e dialogut-gjithë kjo e bën “Aventurat e Pinokut” kryeveprën e letërsisë toskane pas Galileut.

Ashtu siç përbëhet çdo individ prej pjesësh që kundërshtojnë njëra-tjetrën, çdo libër i madh përmbledh

në vetvete shumë shtresa apo shumë shpirtra, që nganjëherë nuk njohin njëra-tjetrën. Mund ta lexojmë “Pinokun” qoftë si histori mizore, qoftë si një histori të mistershme. Kush fillon të shkruajë një përrallë për fëmijë, nuk e merr me mend kurrë se ku do të arrijë. Mendon se do të sheshtojë vetëm batuta të lezeçme apo Aventura argëtuese. Pa e ditur ai, e vjetra, shpirti misterioz i Përrallës pushtohet prej tij dhe e detyron të luajë me shpirtrat e ajrit e të drurit, të kujtojë imazhet e Babait e të Nënës, të tregojë Aventura me vdekje e ringjallje, me mëkat e me shpëtim.

PIETRO CITATI

## *I*

NUK DIHET SI NDODHI QË MJESHTËR  
QERSHIA, MARANGOZ, GJETI NJË COPË  
DRU QË QANTE E QESHTË SI FËMIJË.

Na ishte njëherë...

- Një mbret! - do të thonë menjëherë lexuesit e mi të vegjël. Jo, fëmijë, e keni gabim. Na ishte një herë një copë druri.

Nuk ishte një dru kushedi çfarë, por një copë e thjeshtë nga stiva, nga ato që në dimër futen në soba e në oxhaqe për të ndezur zjarrin e për të ngrohur shtëpinë.

Nuk di si ndodhi, por fakti është se një ditë të bukur kjo copë druri u gjend në dyqanin e një marangozi plak i cili e kishte emrin mjeshtër Antoni, megjithëse të gjithë e quanin mjeshtër Qershia për shkak të majës së hundës së tij, që ishte përherë e ndritshme dhe ngjyrë mavi, si një qershie e pjekur.





Sapo mjeshtër Qershia e pa këtë copë dru, u kënaq i tëri dhe fërkoj duart plot kënaqësi, murmuriti me gjysmë zëri:

- Ky dru më erdhi në kohë: do ta përdor për të bërë një këmbë tavoline.

Me të thënë e me të bërë, mori menjëherë latushën e mprehtë që t'i hiqte lëkurën e ta latonte, por kur po jepte goditjen e parë, mbeti me krahun pezull, sepse dëgjoi një zë të dobët, që tha duke u lutur:

- Mos më godit aq fort!

Merreni me mend si mbeti ai plak i mirë, mjeshtër Qershia!

Rrotulloi sytë e përhumbur për qark dhomës për të parë nga mund të dilte vallë ai zë i dobët e nuk pa askënd! Shikoi poshtë banakut, askush; shikoi brenda një rafti që rrinte përherë i mbyllur, askush; shikoi në shportën e bujashkave e të tallashit, askush; hapi derën e dyqanit për t'i hedhur një sy edhe rrugës, askush! E pra...?

- Kuptova, - tha atëherë duke qeshur e duke kruar parukën, - duket se më bëjnë veshët mua. Vazhdojmë punën.

Dhe mori prapë latushën në dorë dhe e goditi fort copën e drurit.

- Oh! Ti po më vret. - thirri duke u hidhëruar zëri i zakonshëm.

Kësaj radhe mjeshtër Qershia mbeti i shtangur, me

sytë e zgurdulluar nga frika, me gojën e hapur e me gjuhën e varur deri në mjekër, si një statujë shatërvani. Sapo zuri të përmendej, nisi të thoshte duke u dridhur e belbëzuar nga frika:

- Nga doli ky zë që tha oh...? E pra këtu nuk ka shpirt të gjallë. Ç'të jetë vallë kjo copë druri që ka mësuar të qajë e të ankohet si një fëmijë? Unë nuk mund ta besoj. Ky dru, ja tek është këtu; është një copë druri për oxhak, si gjithë të tjerët; e për ta hedhur në zjarr, që të bëjë të vlojë një tenxhere me fasule... E pra...? Të jetë fshehur ndokush brenda? Po qe fshehur kush, aq më keq për të. Tani ia ndreq unë!

E duke thënë kështu, e mbërtheu me të dy duart atë copë të gjorë druri dhe zuri ta përplaste pa mëshirë për muret e dhomës.

Pastaj vuri veshin të dëgjonte, nëse kishte ndonjë zë të dobët që qahej. Priti dy minuta, hiç; pesë minuta, hiç; dhjetë minuta, hiç!

- E kuptova, - tha atëherë duke u munduar të qeshte e duke pështjelluar parukën, - me sa duket atë zërin e dobët që ia bëri "oh", e sajova me imagjinatë! Të vazhdojmë punën.

Dhe për shkak se i kishte hyrë një frikë e madhe, nisi të këndonte nën zë për të marrë pak zemër. Ndërkaq, duke vënë mënjanë latushën, mori zdrukthin, për të zdruguar e lëmuar copën e drurit; por teksa e zdrugonte lart e poshtë, ndjeu zërin e dobët që i tha duke qeshur:

- Mjaft! Po më gudulis trupin!

Këtë herë i gjori mjeshtër Qershia ra si ta kishte goditur rrufeja. Kur hapi sytë, u gjend i rrëzuar përtokë.

Pamja e tij dukej e shfytyruar e madje maja e hundës, nga ngjyrë mavi siç ishte gati gjithmonë, i qe bërë e kaltër nga frika e madhe.

## II

MJESHTËR QERSHIA IA DHURON COPËN E DRURIT MIKUT TË VET XHEPETO, I CILI E MERR PËR TË BËRË NJË KUKULL TË MREKULLUESHME QË TË DIJË TË VALLËZOJË, TË LUAJË ME SHPATË E TË KËRCEJË.

Në këtë çast po trokisnin në portë.

- Hyni pra, - tha marangozi, pa pasur forcë të ngrihej në këmbë.

Atëherë hyri në dyqan një plakush i shkathët, i cili e kishte emrin Xhepeto; por fëmijët komshinj, kur donin ta bënin të tërbohej e thërrisnin me nofkën *Kaçamaku*, për shkak të parukës së tij të verdhë që i ngjante shumë kaçamakut të misrit.

Xhepetoja ishte shumë idhnak. Hall ta thërrisje Kaçamak! Menjëherë bëhej bishë dhe s'kishte gjë që ta mbante.

- Mirëdita, mjeshtër Antonio, - tha Xhepetoja. -  
Çfarë bën aty përtokë?

- U mësoj aritmetikën milingonave.

- Paçi fat!

- Kush ju solli tek unë, kumbar Xhepeto?

- Këmbët. Ta dini mjeshtër Antonio se kam ardhur  
tek ju t'ju kërkoj një nder.

- Ja tek jam, gati t'ju shërbej, - u përgjigj marangozi,  
duke u ngritur në gjunjë.

- Sot në mëngjes më mbiu në tru një ide.

- Ta dëgjojmë.

- Kam menduar të bëj vetë një kukull të bukur druri;  
por një kukull të mrekullueshme, që të dijë të vallëzojë,  
të luajë me shpatë dhe të kërcëjë. Me këtë kukull dua të  
shëtis botën, për të fituar një copë bukë e një gotë verë;  
si ju duket?

- Të lumtë Kaçamak! - thirri zëri i hollë, i zakonshëm,  
që nuk kuptohej nga dilte.

Me të dëgjuar ta thërrisnin “Kaçamak”, kumbar  
Xhepetoja u bë i kuq si një spec nga inati dhe, duke iu  
kthyer marangozit, i tha i xhindosur:

- Pse më fyeni?

- Kush po ju fyen?

- Më thirrët Kaçamak!

- S'kam qenë unë.

- Prit pak të shohësh se ç'do të bëj unë! Unë them se  
keni qenë ju.





- Jo!

- Po!

- Jo!

- Po!

Dhe duke u nxehur gjithnjë e më shumë kaluan nga fjalët në vepra; dhe u kacafytën mes tyre, u gërvishtën, u kafshuan e u bënë fërtele.

Kur mbaroi përleshja, mjeshtër Antonioja u gjend me parukën e verdhë të Xhepetos në duar dhe Xhepetoja vuri re se kishte në gojë parukën me thinja të marangozit.

- Ma kthe parukën time! - thirri mjeshtër Antonioja.

- Dhe ti ma kthe timen e të bëjmë paqe.

Dy plakushët, pasi kishte marrë secili të vetën, shtrënguan duart dhe u betuan të mbeteshin miq të mirë për gjithë jetën.

- Pra, kumbar Xhepeto, - tha marangozi në shenjë paqeje, - cili është nderi që doni prej meje?

- Dua pak dru për të bërë kukullën time: ma jepni?

Mjeshtër Antonioja, krejt i kënaqur, shkoi menjëherë të merrte mbi banak atë copë druri që kishte qenë shkak i gjithë atyre frikërave të tij. Por kur qe duke ia dhënë mikut, copa e drurit bëri një tundje të madhe dhe duke i ikur dhunshëm nga duart, shkoi e u përplas me forcë në kërcinjte e thatë të Xhepetos së gjorë.

- Ah! Me këtë mirësi, mjeshtër Antonio, po ma dhuroni gjënë tuaj? Gati më latë të çalë!



- Ju betohem se nuk isha unë!  
- Atëherë do të kem qenë unë!  
- Gjithë fajin e ka ky dru...  
- E di që është prej drurit: por ishit ju që më gjuajtët në këmbë!

- Unë nuk ju gjuajta!

- Gënjeshtar!

- Xhepeto, mos më fyje; kur nuk të thërras Kaçamak!

- Gomar!

- Kaçamak!

- Mushk!

- Kaçamak!

- Majmun i keq!

- Kaçamak!

Duke e dëgjuar t'i thoshte Kaçamak për herë të tretë, Xhepetos iu errësua shikimi, u hodh mbi marangozin; dhe s'lanë gjë pa i thënë e pa i bërë njëri-tjetrit.

Me të mbaruar beteja, mjeshtër Antonioja u gjend me dy gërvishtje më shumë në hundë dhe ai tjetri me dy kopsa më pak në xhakëtë. Të barazuar kësisoj në llogaritë e tyre, shtrënguan duart dhe u betuan të mbeteshin miq të mirë për gjithë jetën.

Ndërkaq Xhepetoja mori me vete copën e drurit aq të zonjën; dhe pasi falënderoi mjeshtër Antonion, u kthye duke çaluar në shtëpi.

### III

XHEPETOJA, ME T'U KTHYER NË SHTËPI,  
FILLOI MENJËHERË TË BËNTE KUKULLËN DHE I  
VURI EMRIN PINOK. ÇAPKËNLLËQET E PARA  
TË KUKULLËS.

Shtëpia e Xhepetos ishte një dhomëz përdhese që merrte dritë nga një nënshkallë. Orenditë s'kishin ku shkonin më të thjeshta: një karrige e keqe, një shtrat dosido dhe një tavolinë krejt e shkatërruar. Në murin në fund shihej një oxhak me zjarr të ndezur; por zjarri ishte i pikturuar; dhe pranë zjarrit ishte pikturuar një tenxhere që vlonte gjallërisht dhe nxirrte një re avulli, që dukej si avull i vërtetë.

Sapo hyri në shtëpi, Xhepetoja mori menjëherë veglat dhe zuri të priste e të bënte kukullën e tij.

- Çfarë emri t'i vë? - tha me vete. - Dua ta quaj Pinok. Ky emër mund t'i sjellë fat. Kam njohur një familje të tërë Pinokësh: Pinok babai, Pinokja nëna dhe Pinokë



fëmijët, dhe të gjithë e kalonin mirë. Më i pasuri prej tyre kërkonte lëmoshë.

Kur ia gjeti emrin kukullës së tij, filloi të punonte për së mbari dhe i bëri menjëherë flokët, pastaj ballin, pastaj sytë.

Pasi i bëri sytë, merreni me mend mahnitjen e tij kur vuri re se sytë i lëviznin dhe po e shikonin ngultazi.

Xhepetoja, duke e parë ta shikonte me ata dy sy druri, gati ia mori për të keq dhe tha me zemërim:

- Sy të këqij druri, pse më shikoni?

Askush nuk u përgjigj.

Atëherë, pas syve i bëri hundën; por hunda, sapo e bëri, nisi të rritej: dhe rritu e rritu e rritu, u bë në pak minuta një hundë e madhe që nuk mbaronte kurrë.

Xhepetoja i gjerë mudohej t'ia priste, por sa më shumë e priste dhe e shkurtonte, aq më shumë ajo hundë e pafytyrë zgjatej.

Pas hundës i bëri gojën.

Akoma pa e përfunduar, goja filloi të qeshte e ta shpotiste.

- Mos qesh! - tha Xhepetoja qejfmbetur; por njëlloj si t'i fliste murit.

- Mjaft qeshe, po të them! - ulëriti me zë kërcënues.

Atëherë goja e la të qeshurën, por nxori krejt gjuhën jashtë.

Xhepetoja, për të mos i prishur punë vetes, u shtir sikur s'e kishte vënë re e vazhdoi të punonte.





Pas gojës, i bëri mjekrën, pastaj qafën, supet, stomakun, krahët e duart.

Sapo mbaroi duart, Xhepetoja ndjeu se i iku paruka nga koka. U kthye, po ç'të shihnte? Pa parukën e vet në duart e kukullës.

- Pinok! Ma jep shpejt parukën!

Po Pinoku, në vend që t'ia kthente, e ngjeshi më tepër në kokën e tij.

Me këtë veprim të pacipë e tallës, Xhepetoja u trishtua dhe u mërzit, si kurrë në jetë; dhe duke iu drejtuar Pinokut, tha:

- Djalë i keq! Akoma nuk je bërë dhe nuk po respekton babanë tënd! Keq, biri im, keq!

Dhe fshiu një lot.

Mbeteshin për t'u bërë kofshët dhe këmbët.

Kur Xhepetoja mbaroi së bëri këmbët, ndjeu një shkelm në majë të hundës.

- Mirë të më bëhet! - tha atëherë me vete. - Duhej ta mendoja më parë! Tani është vonë!

Pastaj mori kukullën në krahë dhe e vendosi mbi dyshemenë e dhomës që të ecte.

Pinoku i kishte këmbët e mpira e nuk dinte të lëvizte; Xhepetoja e mbante për dore për ta mësuar të hidhte hapat.

Kur këmbët nisen t'i çmpiheshin, Pinoku filloi të ecte dhe të vraponte vetë nëpër dhomë, derisa, kur





kaloi derën e shtëpisë, kërceu në rrugë e ia dha vrapit.

E Xhepetoja i gjoë i vraponte pas pa mundur ta mbërrinte, sepse ai çapkën Pinoku shkante duke kërcyer si lepur dhe duke rrahur këmbët e tij të drunjta mbi kalldrëmin e rrugës, bënte një zhurmë të madhe sa njëzet palë nallane fshatarësh.

- Kapeni! Kapeni! - ulërinte Xhepetoja; por njerëzit që ishin në rrugë, duke e parë këtë kukull druri që vraponte si kalë, ndaleshin të habitur ta shihnin; qeshnin e qeshnin sa s'merret me mend.

Për fat të mirë u gjend një polic i cili duke dëgjuar gjithë poteren e duke kujtuar se ishte një këriç që i kishte ikur të zotit, qëndroi me këmbë të hapura në mes të rrugës, me qëllim që ta ndalte e të pengonte ndonjë rrëmujë më të madhe.

Por Pinoku, kur pa nga larg policin që po pengonte rrugën, u orvat t'i kalonte, në befasi, për shalësh, por dështoi.

Polici, pa luajtur vendit, e kapi pincë për hunde (ishte një hundë tejet e madhe, që dukej se ishte bërë enkas për t'u kapur nga policët) dhe e dorëzoi në duart e Xhepetos, i cili në shenjë qortimi donte t'i shkulte menjëherë veshët. Po imagjinojeni si mbeti kur, duke kërkonte veshët, nuk arriti t'i gjente: e dini pse? Sepse në nxitimin për ta gdhendur, kishte harruar t'ia bënte.

Atëherë e kapi për zverku dhe teksa e çonte prapa, i tha duke i tundur kokën me kërcënim:



- Shkojmë në shtëpi. Kur të futemi brenda, pa dyshim do të lajmë hesapet!

Pinoku, kur dëgjoji këtë, u shtri përtokë dhe nuk desh të ecte më. Ndërkaq kureshtarët e bjerraditët nisën të grumbulloheshin aty.

Dikush thoshte diçka, dikush diçka tjetër.

- E shkreta kukull! - thoshin disa. - Ka të drejtë që nuk do të kthehet në shtëpi. Kushedi sa do ta rrahë ky njeri i keq!

E të tjerët shtonin me ligësi:

- Ai Xhepetoja duket burrë zotni! Por është një katil i vërtetë me fëmijët! Po t'ia lënë këtë kukull në duar, është në gjendje ta copëtojë!

Shkurt, thanë e bënë aq shumë, sa polici e la të lirë Pinokun dhe çoi në burg Xhepeton e shkretë, i cili duke mos gjetur fjalë aty për aty të mbrohej, qante si viç e teksa shkante drejt burgut, belbëzonte e qante me dënësë.

- Fëmijë i mallkuar! E të mendosh sa jam munduar për të bërë një kukull për së mbari! Por mirë e kam! Duhej ta kisha menduar më parë!

Ajo që ndodhi më vonë është një histori për të mos u besuar dhe do t'jua tregoj në kapitujt e tjerë.